



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 512/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Adnan Konushevcu dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Besart Ademi, duke vendosur përkritazi me ankesën e koalicionit NISMA-AKR-PD, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 24.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

PRANOHET e bazuar ankesa Anr. 512/2019 e datës 24.11.2019, e paraqitur nga koalicioni NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, **URDHËROHET** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), që 1 (një) fletëvotim në Vendvotimin 2717B/03D, të vlerësohet i vlefshëm, dhe i njëjti ti bashkëngjitet rezultatit përfundimtar të publikuar me datë 07.11.2019.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 24.11.2019, ka pranuar ankesën Anr.512/2019 nga koalicioni NISMA-AKR-PD, në të cilën pretendohet se me datë 23.11.2019 në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), gjatë procesit të rinumërimit, në Vendvotimin me numër 2717B/03D, është shpallur i pavlefshëm 1 fletëvotim, ku sipas parashtresës së ankesës, QNR-ja, pa të drejtë e ka konsideruar të pavlefshëm këtë fletëvotim, për arsye se në rubrikën e subjektit politik me nr.112 ekziston një pikë e cila fare pak shihet e për të cilën konsiderojnë se ka mundur të vij si pasojë e ndërhyrjes nga një dorë e trete, ku e njëjta nuk paraqet dhe nuk ka kurrfarë baze që ky fletëvotim të jete i pa vlefshëm. Ndërsa shenja “TIK” është e vendosur në rubrikën e subjektit politik koalicionit Nisma-AKR- pasi që në rubrikën e subjektit me nr.134, është vendosur një pikë edhe pse kjo vështirë vërehet dhe e njëjta ka mundur të jetë nga printeri në momentin e shtypjes, defekt ky i cili nuk paraqet asnjë pengesë sa i përket vlerësimit të vlefshmërisë së këtij fletëvotimi. Më tutje parashtresuesi i ankesës thekson se ky fletëvotim duhet të shpallet i vlefshëm duke u bazuar në Doracakun e Procedurave të Votimit dhe Numërimit të KQZ-së, shtojca nr.7 (Mostër e fletëvotimit të vlefshëm), pasi që “TIKU” është i vendosur në mënyrë të rregullt në rubrikën e koalicionit NISMA-AKR-PD me nr.122.

Si provë për pretendimet e tyre, ankesës i kanë bashkangjitur shtojcën nr.7 (Mostër e fletëvotimit të vlefshëm) dhe kopjen e fletëvotimit të ankimuar.

Në përgjigjen e KQZ-së, të pranuar përmes email-it, më datë 19.11.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese thekson se në ligjin për zgjedhje ceket se kur fletëvotimi shpallet i vlefshëm në rast se dihet qëllimi i qarte i votuesit, me tutje theksohet se në rastet kur në fletëvotim është shënuar subjekti dhe tek një subjekt tjetër kemi një pikë që në bazë të doracakut e kategorizon si të pavlefshëm, por ajo pika apo shenja e dytë tek subjekti tjetër është shumë e vogël milimetrike. Në të gjitha rastet kur shihet se pika është nga printimi apo ndonjë ngjyrë tjetër përpos stilografit, ai fletëvotim është shpallur i vlefshëm por kemi raste kur edhe pse ajo pike është shumë milimetrike por është gjurmë e stilografit dhe ai fletëvotim bazuar në doracak shpallet i pavlefshëm.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe vlerësimit të provave të bashkangjitura, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga shkresat e lëndës konstatohet se në kutinë e votimit 1001D/04R është shpallur i pavlefshëm 1 fletëvotim nga ana e QNR-së, pasi që në fletëvotim shihet një pikë e vendosur në rubrikën e subjektit politik LDK me numrin rendor 134, dhe shenja tik tek koalicioni NISMA-AKR-PD me numër rendor 122. Si rezultat i këtyre konstatimeve QNR-ja, me rastin e rinumërimit e ka shpallur të pavlefshëm këtë fletëvotim.

Koalicioni NISMA – AKR – PD, si palë ankuese, në kuptim të nenit 105 paragrafi 1 të LZP-së, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë në PZAP, ku ka kërkuar që ky fletëvotim të shpallet i vlefshëm pasi që “TIKU” është i vendosur në mënyrë të rregullt në rubrikën e koalicionit NISMA-AKR-PD me numër rendor 122.

Paneli, me rastin e pranimit të ankesës dhe përgjigjes në ankesë ka formuar ekipin hetues dhe ka dërguar në QNR, për të zhvilluar hetime në raport me pretendimet e cekura nga ankuesi. Pas përfundimit të hetimit në QNR, ekipi hetues ka gjetur se qëndron pretendimi i ankuesit se fletëvotimi i gjetur në kutinë e votimit 1001D/04R duhet të shpallet i vlefshëm pasi që “TIKU” është i vendosur në mënyrë të rregullt në rubrikën e koalicionit NISMA-AKR-PD me nr.122 dhe se pika e vendosur në rubrikën e subjektit me nr.134 vështirë vërehet.

Në fletëvotimin që është ekzaminuar shihet se në rubrikën me numër 122 të koalicionit NISMA-AKR-PD, është shënuar shenja tik ndërsa tek rubrika me numër 134 të subjektit politik LDK, është një pikë e cila nuk ka të bëjë fare me vullnetin e votuesit. Kështu që Paneli ka shpallur të vlefshëm këtë fletëvotim, pasi që nga ekzaminimi i të njëjtit ka rezultuar se i përmbush kriteret e vlefshmërisë, dhe duhet t'i bashkëngjitet rezultatit përfundimtar të publikuar me datë 07.11.2019.

PZAP-i, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura vendimin e ka bazuar në nenin 119 paragrafi 5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*”, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rezultati që del nga vlefshmëria e fletëvotimit si në dispozitiv të këtij vendimi, e të cilin fletëvotim e gjeni te bashkangjitur me këtë vendim, duhet të përfshihet në rezultatin përfundimtar të shpallur me datë 07.11.2019.


Andaj, Paneli në kuptim të nenit 117, 118 dhe nenit 120 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 512/2019 më datën 24.11.2019

Kryesues i Panelit
Ferki Xhaferi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.



ZAJEDNI

Shënim: VETËM NJË subjekt politik
detyrohet të zgjedhë SAIPO, SAIMO, SAIMO
SADECE BIR shtypsi, kurullëgu shtypsiin

- 111. PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE - PLE
- 112. POK PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - PDK
- 113. PMA / PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM - PAI
- 114. STRANKA DEMOKRATSKJE AKCIJE - SDA
- 115. PARTIA KOSOVSQIJK SRBA - PKS
- 116. PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS - POAK
- 117. POKRET ZA GORA - PG
- 118. NOVA DEMOKRATSKA STRANKA - NDS
- 119. AAK- PSD - KOALICIONI 100% KOSOVË
- 120. SLOBODA
- 121. SAMOSTALNA LIBERALNA STRANKA - SLS
- 122. NISMA SOCIALDEMOKRATË ALEANCA KOSOVA E RE PARTIA E DREJTËSISË
- 123. JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA - JGP
- 124. KOALICIJA VAKAT
- 125. FJALA
- 126. LËVIZJA VETËNDOSJËJ
- 127. KOSOVA DEMOKRATIK TURK PARTISI - KDTP
- 128. PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS - PREBK
- 129. PARTIA EUROATLANTIKE E KOSOVËS - PEK
- 130. KOSOVARI NEVI ROMANI PARTIA - KNRP
- 131. INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS - IRDK
- 132. ESMIR KASBI
- 133. GRADANSKA INICIATIVA GORE - GIG
- 134. LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - LDK
- 135. SRPSKA LISTA

**NË REPUBLIKËN E KOSOVËS 2010
I REPUBLIKËN KOSOVO 2010
:GLISI ENKEN SECIMLISI**

Shënim: ME SHËRIMT PËSË sandësi
Detyrohet NJËRË PËT sandësi
EN PAZLA BËSË shtypsiin

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33	34	35	36	37	38	39	40	41	42	43	44	45	46	47	48	49	50	51	52	53	54	55	56	57	58	59	60	61	62	63	64	65	66	67	68	69	70	71	72	73	74	75	76	77	78	79	80	81	82	83	84	85	86	87	88	89	90	91	92	93	94	95	96	97	98	99	100	101	102	103	104	105	106	107	108
---	---	---	---	---	---	---	---	---	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----



Republika e Kosovës
 Republika Kosovë - Republic of Kosovo
 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
 Centralna Izborna Komisija
 Central Election Commission



**ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PËR KUVË
 PREVRËMENI IZBORI ZA SKUPSH
 2019 KOSOVA CUMHURIYE**

1

Shënimi **VETËM NJË** subjekt politik
 Oznaçite **SAMO JEDAN** politiki subjekat
SADECE BIR siyasi kuruluşu işaretleysin

111. **PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE - PLE**

112. **PDK** **PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - PDK**

113. **PAI** **PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM - PAI**

114. **STRANKA DEMOKRATSKE AKCIJE - SDA**

115. **PARTIJA KOSOVSKIH SRBA - PKS**

116. **PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS - PDAK**

117. **POKRET ZA GORA - PG**

118. **NOVA DEMOKRATSKA STRANKA - NDS**

119. **AAK- PSD - KOALICIONI 100% KOSOVË**

120. **SLOBODA**

121. **SAMOSTALNA LIBERALNA STRANKA - SLS**

122. **NISMA SOCIAL DEMOKRATE** **ALEANCA KOSOVA E RE** **EDP**

Apr. 5.12.19
 2717B/03D